



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/16

Datë: 30.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-221, Ligjin 04/L-116, Ligjin 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 16, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Tremujor i Buxhetit për vitin 2026.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform kërkesave të nenit 45 të Ligjit 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/16
Datë: 30.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe Vendimit të Qeverisë me Nr. 02/02, të datës 20.02.2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Financave për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 04/09, të datës 10.04.2026, për bartjen e shpenzimeve buxhetore nga ministrinë amë në ministrinë e reja të krijuara, sipas tabelës së bashkëngjitur.
2. Obligohen ministrinë që, në ato linja ku janë krijuar zotime dhe obligime që prekin ministrinë e reja, t'i lirojnë këto zotime dhe obligime, me qëllim të mundësimin të bartjes së shpenzimeve në ministrinë e reja të krijuara.
3. Pikat e tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 04/09, të datës 10.04.2026, mbeten të pandryshuara.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/16
Datë: 30.04.2026

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafit 8. të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të Promovimit të Republikës së Kosovës, i ndahen mjete buxhetore në vlerë prej 45,000.00€ (dyzetepesë mijë euro) Forumit Ekonomik të Vjenës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nënprogrami për Promovim të Vendit dhe barten në xhironlogarinë e Raiffeisen Landesbank NOE-Wien AG, 1030 Wien/Vienna, Austria, Account No.: 9548850, BLZ 32000, BIC: RLNWATWW, IBAN: AT76 3200 000009548850.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/16

Datë: 30.04.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 64 dhe 66 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125 dhe nenin 14, të Statutit (QRK) Nr. 01/2023 të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, me këtë përbërje:
 - 1.1. Dr. Faik Shatri - Qendra Klinike Universitare e Kosovës;
 - 1.2. Dr. Tetore Olloni - Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;
 - 1.3. Dr. Ardita Baraku - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik;
 - 1.4. Z. Osman Hajdari - Spitali i Përgjithshëm Prizren në bazë të rotacionit dhe përmbushjes së indikatorëve të kualitetit të shërbimeve shëndetësore;
 - 1.5. Dr. Vjollca Zeqiri - Shërbimet e Kujdesit Parësor Shëndetësor;
 - 1.6. Z. Mentor Sadiku - Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.7. Një (1) ekspert i menaxhmentit shëndetësor, i zgjedhur në bazë të konkursit publik.
2. Bordi Drejtues i përgjigjet Qeverisë nëpërmjet Ministrit të Shëndetësisë.
3. Bordi Drejtues udhëhiqet nga Kryesuesi me mandat një (1) vjeçar, i cili zgjidhet në bazë të parimit të rotacionit nga anëtarët e tij.
4. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues është tre (3) vjeçar.
5. Shfuqizohen Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 22/140, i datës 26.04.2023, dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/208, i datës 13.06.2024.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/16

Datë: 30.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2023 për Shkollimin Specialistik, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesën e pesëdhjetedy (52) specializanteve lehona nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nënprogramin "Aftësimi Specialistik" dhe EVM kod 90300, në vlerë prej 475,051.50€ nga data 01.11.2025 deri me datën 31.12.2026.
2. Obligohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe institucionet e tjera relevante t'i kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/16
Datë: 30.04.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 44 dhe 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në pajtim me nenin 15 të Ligjit nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Grupi Koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore në këtë përbërje:
 - 1.1. Donika Gërvalla Schwarz - Koordinatore Kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore, kryesuese;
 - 1.2. Edi Gusia - Agjencia për Barazi Gjinore, zëvendëskryesuese;
 - 1.3. Zëvendësministër/e - Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 1.4. Agon Dobruna - Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, anëtar;
 - 1.5. Besiana Havolli - Ministria e Drejtësisë, anëtar;
 - 1.6. Arsim Berisha - Ministria e Shëndetësisë, anëtar;
 - 1.7. Përparim Kryeziu - Ministria e Arsimit dhe Shkencës, anëtar;
 - 1.8. Arton Konushevc - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 1.9. Zëvendësministër/e - Ministria e Financave, anëtar/e;
 - 1.10. Arbnesht Ajvazi - Policia e Kosovës, anëtar;
 - 1.11. Laura Pula - Prokuroria e Shtetit, anëtar;
 - 1.12. Dardan Kadolli - Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtar;
 - 1.13. Luljete Hietemi - Akademia e Drejtësisë, anëtare;
 - 1.14. Zana Hamiti - Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës, anëtar;
 - 1.15. Burhan Maxhuni - Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, anëtar, dhe
 - 1.16. Adelina Rexhepi Braha - Përfaqësuese e Qendrës për Punë Sociale, anëtare.
2. Me ftesë të Kryesueses, mund të ftohen edhe përfaqësues të ministrive të tjera dhe institucioneve të tjera relevante, varësisht nga detyrimet që dalin nga strategjia për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve strategjikë në cilësinë e vëzhguesve.
3. Grupi Koordinues, sipas pikës (1) të këtij Vendimi, obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e tij, t'i kryejë në pajtim me Ligjin nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/16
Datë: 30.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë si dhe në përputhje me nenin 15 të Rregullores Nr. 26/2012 e Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e ish të Burgosurve, të ish të Dënuarve e të ish të Përndjekurve Politikë, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 17/47 të datës 10.12.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/24, të datës 11.08.2021 si dhe Vendimin e Qeverisë Nr.12/191 të datës 05.03.2024

1. I vazhdohet mandati Sekretarisë së Komisionit Qeveritar për njohjen e statusit të ish dënuarve dhe ish të përndjekurve politik në afat kohorë prej dy (2) vjeçar, në këtë përbërje:
 - 1.1. Shefik Sadiku, udhëheqës i Sekretarisë;
 - 1.2 Naime Sherifi, zyrtar;
 - 1.3. Faik Ajeti, zyrtar.
 2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarisë janë ofrimi dhe mbështetja tekniko-administrative e komisionit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- Kompensimi i anëtarëve të Sekretarisë për angazhimin e tyre mbetet i njëjtë si në vendimin e Qeverisë me Nr. 12/191 i datës 05.03.2024.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me qëllim të realizimit të autorizimeve, detyrave dhe objektivave që derivojnë nga legjislacioni përkatës në fuqi si dhe me qëllim të ofrimit të mbështetjes teknike dhe administrative për Komisionin dhe me qëllim të mbarëvajtjes së punës në Komision si dhe duke pas parasysh legjislacionin përkatës në fuqi për punën e Komisionit dhe Sekretarisë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/16
Datë: 30.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19 të Ligjit Nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish-të Dënuarve dhe ish-të Përndjekurve Politikë, si dhe në përputhje me nenin 4 të Rregullores Nr. 26/2012 të Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e ish-Burgosurve, të ish-të Dënuarve e të ish-të Përndjekurve Politikë, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/24, të datës 11 gusht 2021, i plotësuar dhe i ndryshuar me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/24, të datës 11.08.2021, Vendimin e Qeverisë Nr. 06/73, të datës 30.04.2022, si dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 11/191, të datës 05.03.2024

1. I vazhdohet mandati Komisionit Qeveritar për njohjen e statusit të ish-të dënuarve dhe ish-të përndjekurve politikë, në afat kohor dy (2) vjeçar, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fadil Bunjaku, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
 - 1.2. Bora Duli, përfaqësuese nga Ministria e Financave;
 - 1.3. Jahë Gecaj, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.4. Arijeta Rexhepi, përfaqësuese nga Kuvendi i Kosovës;
 - 1.5. Berat Luzha, përfaqësues nga Shoqata e ish-të Burgosurve Politikë të Kosovës;
 - 1.6. Mazllum Baraliu, përfaqësues nga Shoqata e Juristëve të Kosovës.
2. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij Vendimi që të veprojë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish-të Dënuarve dhe ish-të Përndjekurve Politikë, me Rregulloren Nr. 26/2012 të Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e ish-të Burgosurve, të ish-të Dënuarve e të ish-të Përndjekurve Politikë, si dhe me dispozitat e tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë